



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 521 Prot.

Patos, më 17/02/2025

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKT – VENDIM

Nr. 9 datë 17/02 /2025

PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR
QYTETARIN QEREM ZYBERI

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social” pika 2, gërma “a” dhe V.K.M-së nr. 459 datë 03.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufruktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe V.K.B-së nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë bonusin e qirasë për periudhën 1-vjeçare Janar - Dhjetor 2025 për qytetarin z. Qerem Zyberi në vlerën 36.000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë.
2. Ky rimbursim të bëhet me 2 (dy) këste pasi qytetarit mund t’i ndryshojë statusi social, dhe me vërtetimin pas 6-muajsh të rimbursohet pjesa e mbetur.

Ekipi i Menaxhimit të Programit të Strehimit Social

Ermenita Mici
Drejtuese Programit

Fabjola Hoxha
Anëtar

Nurkë Hazizaj
Juriste

Arben Shpërdheja
Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 5211 / Prot.

Patos, më 17/02/2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT TË QIRASË PËR
QYTETARIN QEREM ZYBERI**

Në vijimësi të kërkesës të z. Qerem Zyberi për të përfituar bonusin e qirasë si familje në nevojë theksojmë se:

Z. Qerem Zyberi banues në lagjen "Naftëtari" Patos, ka plotësuar dokumentat për tu trajtuar me një nga format e strehimit sipas ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin Social", dhe figuron në listën e strehimit. Familja e tij përbëhet nga 5 persona. Bazuar normave të strehimit kjo familje duhet të strehoet në banesë 2+1. Të ardhurat e familjes janë në total 22,304 (njëzetë e dy mijë e treqind e katër) lekë. Sipas kontratës së qirasë me nr. repertori 431, nr. koleksioni 197, datë 01.03.2022, familja e z. Qerem Zyberi jeton në këtë banesë, me numër pasurie 21/11+3-25, zona kadastrale 2890, volumi 13, faqe 54, me sipërfaqe 49 m² (dyzetë e nënë) në lagjen "Naftëtari", me një afatë kohor kontrate 1 (një) vjeçarë. Në V.K.B nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit 2025, është miratuar zëri rimbursimi i familjeve të pastreha për bonus qiraje. Për familjet që si pjesë taksuese sipas normave të strehimit duhet të strehoen në banesën 2+1, vlera në tregun e lirë e tetstuar është 6,000 (gjashtë mijë) lekë dhe rimbursim 50% e vlerës është e barazvlefshme me 3,000 (tre mijë) lekë në muaj. Për periudhën një vjeçare Janar-Dhjetor 2025 një vlerë totale 36,000 (tridhjetë e gjashtë mijë) lekë. Kjo vlerë të rimbursohet me dy këste, pasi qytetarit mund ti ndryshoj statusi social. Në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" pika 2, gërma "a" dhe V.K.M-së nr. 459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionin e qirasë ose uzufruktit, mënyra e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehim, si dhe V.K.B-së nr. 87 datë 19.12.2024 për miratimin e buxhetit, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë, miratimin e këtij projektvendimi.

Ekipi i Menaxhimit të Programit të Strehimit Social

Ermenita Mici

Fabjola Hoxha

Arben Shpërdheja

KRYETARI
Fation Duro